

E nderuara kliente, i nderuari klient,

ju përshëndesim shumë përzemërsisht në Mittelbrandenburgische Sparkasse (MBS). MBS-ja është instituti rajonal financiar për rajonet Potsdam, Brandenburg (Havel), Potsdam-Mittelmark, Havelland, Oberhavel, Teltow-Fläming dhe Dahme-Spreewald. Jemi gjithmonë në afërsinë tuaj me mbi 150 degë dhe jemi gjithmonë në linjë në [www.mbs.de](http://www.mbs.de). Këshilltarët tona dhe këshilltarët tanë në degë janë ekspertë me formim të posaçëm për shërbime financiare sipas së drejtës gjermane.

Ju ofrojmë shërbime të shumta: Me rëndësi të veçantë për ju është **xhirollogaria** me funksionet e saj të shumta. **Xhirollogarinë mund ta përdorni vetëm në përmasën e depozitës suaj.**

- Në xhirollogarinë tuaj bashkohen të ardhurat dhe shpenzimet tuaja. Kësaj i përkasin pagimet tuaja elektronike (p. sh. xhirime) ashtu si tërheqje monetare ose hyrje me para në dorë në automat parash ose në sportel. Pagesat, xhirimet dhe pagime të tjera mund të kryhen vetëm përderisa ka depozitë.
- Për ta parë të përgjithshmen, merrni pasqyra llogarie nga printeri i pasqyrave llogarie, në të cilat janë të renditura të gjitha regjistrimet.
- Për llogarinë tuaj paguani çdo muaj një pagesë për mbajtjen e llogarisë si dhe taksa regjistrimesh që varen nga intensiteti i shfrytëzimit të llogarisë.
- Për hapjen e një xhirollogarie na duhen dokumentet tuaja të identifikimit.  
**Ju lutem kini parasysh që për arsye ligjore, bashkëpunëtorët tanë mund të pranojnë vetëm dokumente identifikimi të njohura ligjërisht. Në qoftë se nuk keni letra njoftimi të tilla, ju lutem drejtohiuni ambasadës së vendit tuaj ose zyrës lokale të regjistrimit të banorëve në komunën tuaj.**

Informacione të rëndësishme për funksionet e llogarisë suaj:

#### **SparkassenCard:**

- Për depozitime dhe pagesa në sportel ose në automatin e parave do të merrni një SparkassenCard. Pagesat kryhen vetëm në kadër të depozitave në dispozicion.

#### **Të holla në automatin e parave:**

- Me një numër sekret (PIN - numër personal identifikimi) mund të tërhiqni para falas në të gjitha automatet e parave të Sparkasse-s. Në automate parash të bankave të tjera mund të kërkohen pagime të tjera. PIN-i është i rëndësishëm edhe kur doni të paguani me kartë në dyqan.
- Numri duhet mbajtur rreptësisht sekret. Nuk duhet t'u kalohet njerëzve të tjerë dhe duhet të mbahet gjithmonë i ndarë nga karta.
- Automati i parave paguan vetëm në kartmonedha.
- Funksionimin e aparatit të parave e kemi paraqitur në ilustrimin e bashkangjitur. Në rast se keni nevojë për më shumë ndihmë për ta përdorur automatin, ju lutem drejtohiuni bashkëpunëtorëve tanë në degë,
- Nëse e humbni kartën tuaj, ju lutem njoftoni menjëherë degën tuaj. Kartën mund ta bllokoni në çdo kohë falas në gjithë Gjermaninë nën numrin e telefonit 116 116.

**IBAN:**

Nëpërmjet qarkullimit të pagesave pa para në dorë mund të pranoni shuma parash dhe të kryeni xhirime. Për këtë ju duhet IBAN-i (International Bank Account Number, numri ndërkombëtar i llogarisë bankare), të cilin e gjeni në anën e pasme të SparkassenCard-it tuaj. Këtë IBAN jepiani, ju lutem, partnerëve tuaj kontraktualë, p. sh. punëdhënësit, zyrës së punës ose enteve të tjera zyrtare. Numri juaj i llogarisë është pjesë e IBAN-it.

**Xhirime SEPA:**

Xhirimet ju japin mundësinë për të paguar shuma të njëhershme, si fatura, pa para në dorë, kur i jepni MBS-së një urdhërshirim (në një formular xhirimi SEPA ose nëpërmjet shërbimit bankar në linjë), shuma e dëshiruar regjistrohet në llogarinë e pranuesit të shënuar dhe debiton llogarinë tuaj.

**Urdhërshirimi periodik:**

Kur i jepni MBS-së një urdhërshirim periodik, ajo i transferon marrësit para në intervale të rregullta. Ju vendosni sa paguhet, kur dhe sa shpesh. Një urdhërshirim është i përshtatshëm për shuma gjithmonë të njëjta, p. sh. për qiranë.

**Debitimi SEPA:**

Me një debitim i lejoni pranuesit të pagesave të tërheqë një herë ose periodikisht shumën e detyruar, p. sh. faturën e telefonit, nga llogaria juaj. Shumë e rëndësishme: Ju lutem vini re që për regjistrime të tilla të keni një depozitë të mjaftueshme në llogarinë tuaj.

**Shënime të tjera:**

Për t'iu shmangur pritjeve të gjata, ju lutemi që sipas mundësisë ta vizitoni degën tonë jo menjëherë në fillim të muajit, por disa ditë më vonë. Sepse degët tona frekuentohen më shumë sidomos në fillim të muajit.

Ju lutem na njoftoni në qoftë se nuk keni nevojë më për llogarinë, p. sh. kur transferoheni në një qytet tjetër ose largoheni përfundimisht nga Gjermania. Atëherë mund të mbyllni llogarinë tuaj dhe nuk ju lindin shpenzime të tjera.

Kur lidhni kontrata, për shembull me një ndërmarrje telekomunikimi, ju lutem vini re që të keni gjithmonë një depozitë të mjaftueshme në llogarinë tuaj për t'u përgjigjur detyrimeve tuaj. Përndryshe rrezikoni shpenzime të larta dhe mbylljen e detyruar të llogarisë. Atëherë hapja e një llogarie të re nuk do të ishte më e mundshme.

*Ky është një informacion i padetyrueshëm. Vetëm kontrata e llogarisë ka detyrim ligjor.*